

# ADINGPOKS 1

*Grëshirë e dukshme dy-komponentëshe epoksidike me viskozitet të ulët pa hollues për impregnim dhe mbrojtje të sipërfaqeve të betonit  
I përgjigjet standardit EN 1504-2:2004/ 2.2 (C); 5.1 (C); 6.1 (C); 8.2 (C) dhe EN 13813:2002/SR B2.0-IR20*

## FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për: mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit të ekspozuara nga ngarkesa fizike e mekanike dhe agresionit kimik, për impregnim dhe përmirësimin e veçorive fizike dhe mekanike të betonit. Për sanacion konstruktiv(ndërtues) të sipërfaqeve të armiro-betonit me derdhje ose injektim të plasaritjeve dhe mbushjen e ankerëve.

Gjatë përzjerjes së rërës së kuarcit mund të fitohet llaç epoksidik me karakteristika të larta fiziko-mekanike, i cili mund të aplikohet gjatë sanacionit të dëmtimeve të konstruksioneve të betonit.

## CILËSITË

- Adezion i shkëlqyeshëm për lloje të ndryshme të bazave(nënshtresave);
- Rezistencë e lartë abrazive;
- Rezistencë solide për thartirat(acidet) e holluara;
- rezistencë ndaj solucioneve të kripërave dhe vajrave minerale;
- nuk përmban hollues;
- jo toksik në gjendje të lidhur;
- I rezistueshëm ndaj baktereve;

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

|                                                                                                                                                           |             |                                       |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|---------------------------------------|
| Rezistenca ndaj agresionit të fortë kimik (benzinë, naftë, vaj motori, 10% CH <sub>3</sub> COOH, 20% H <sub>2</sub> SO <sub>4</sub> , 20% NaOH, 20% NaCl) | EN 13529    | klasi II, reduktimi i fortësisë ≤ 50% |
| Fortësi e shtypjes                                                                                                                                        | EN 12190    | >60MPa                                |
| Koha e hapur për aplikim në temperaturë prej 20°C                                                                                                         | EN ISO 9514 | 50-70min                              |
| Koha midis hedhjes së shtresës së parë dhe të dytë në 25°C                                                                                                | -           | 24h                                   |
| Fortësia fillestare ditën e parë, në 25°C, Shore D                                                                                                        | EN ISO 868  | 45 - 55                               |
| Fortësia fillestare ditën e 7-të, në 25°C, Shore D                                                                                                        | EN ISO 868  | 60 - 70                               |
| Temperatura e bazës dhe ajrit gjatë aplikimit                                                                                                             | -           | 10-30°C                               |
| Lagështia relative e ajrit                                                                                                                                | -           | < 7%                                  |
| Përdorimi mekanik për qarkullim të lehtë në temperaturë prej 20°C                                                                                         | -           | pas 3 ditësh                          |
| Përdorimi mekanik për qarkullim të rëndë në temperaturë prej 20°C                                                                                         | -           | pas 7 ditësh                          |
| Përdorimi kimik(duke përfshirë edhe kontaktin me ujë), në 20°C                                                                                            | -           | pas 15 ditësh                         |

## METODOLOGJIA E REALIZIMIT

Faqja 1 nga 4

## **PËRGATITJA E BAZËS(NËNSHTRESËS)**

Baza(nënshtresa) e betonit duhet të jetë e shëndoshë, e thatë, jo e yndyrshme, pa pluhur, pa kondenzat dhe domosdo e hidroizoluar me qëllim që të pengohet shfaqja e presionit negativ hidrostatik.

Lagështia e bazës(nënshtresës) duhet të jetë më e vogël se 7%, kurse temperatura gjatë aplikimit nga 10 deri 30°C. Lagështia relative e ajrit gjatë ndërtimit(aplikimit) duhet të jetë më e vogël se 70%, me qëllim të evitimit të kondensimit të sipërfaqes në përpunim. Nëse nuk respektohet ky kufizim, mund të shfaqen ndryshime estetike të mbështjellësit të lyer, por veçoritë fizike dhe kimike të materialit do të mbeten të pandryshuara.

### **Baza(nënshtresa) e re e betonit**

Betoni duhet të jetë i vjetër minimum 28 ditë, të jetë me forcë minimale të presionit prej 25 MPa dhe të mos përmbajë lagështi më shumë se 7%. Lëngu("qumështi") i çimentos i dalë në sipërfaqe, mbeturinat e llaçit, njollat nga boja dhe vaji, duhet të hiqen në mënyrë mekanike. Në fund, baza(nënshtresa), duhet të pastrohet nga pluhuri me anë të thithëses industriale.

### **Baza e vjetër e betoni**

Mënjanimi i "qumështit të çimentos", vajrave të depërtuara dhe papastërtive në bazë duhet të bëhet në mënyrë mekanike.

Të gjitha dëmtimet e bazës duhet të sanohen duke përdorur materiale përkatëse të parapara për riparime të konstruksioneve të ndërtimeve të betonit.

### **Baza e vjetër epoksidike**

Për sanacionin e sipërfaqeve ekzistuese epoksidike, para hedhjes së mbështjellësit(lyerësit)të ri epoksid, nevojitet që të bëhet vlerësimi(hulumtimi) i cilësisë së mbështjellësit(lyerësit) të vjetër epoksidik me analizën e adezionit(me pull-off test). Nëse rezultatet e fituara janë të kënaqshme, duhet të bëhet thepësimi (vrazhdësimi) i lehtë makinerik dhe pastrimi i pluhurit nga sipërfaqja bazë. Nëse rezultatet nuk janë të kënaqshme, sipërfaqja e vjetër epokside duhet të mënjanohet tërësisht.

## **APLIKIMI SI MBËSHTJELLËS(LYERËS) PËR IMPREGNIM DHE MBROJTJEN E SIPËRFAQEVE TË BETONIT**

Adingpoks 1, si lyerës(mbështjellës) hidhet mbi sipërfaqen bazë(nënshtresën) me trashësi të barazuar, me anë të mistrisë së gomës("gletares së gomës") ose rulit me fibra leshi. Te bazat tejet poroze mund të hidhet në dy shtresa. Te bazat me fuga punuese, duhet që edhe ato të mbushen me stuko epoksidik. Materiali përgatitet me përzierjen e komponentëve A dhe B me përzierës(mixer) të ngadalshëm elektrik(300 deri 500 rrotullime/min) deri në barazimin("njëjtësimin") e plotë. Sasia e materialit që përzihet duhet të jetë në harmoni me kohën e hapur për punë me materialin.

## **MBUSHJA(HEDHJA) DHE INJEKTIMI I PLASARITJEVE DHE ANKERËVE**

Gjatë kryerjes së sanacionit konstruktiv te elementet e betonit, Adinproks 1 përdoret për mbushjen e plasaritjeve ekzistuese në beton. Materiali përgatitet me përzierjen e komponentëve A dhe B me përzierës(mixer) të ngadalshëm(300 deri në 500 rrotullime/min) deri në barazimin e plotë dhe hedhjes së saj të drejtpërdrejtë (për sipërfaqe horizontale)në plasën(të çarën). Në mënyrë alternative, materiali i përgatitur Adinproks 1 mund të hidhet me injektim nën shtypje në plasën nëpërmjet pakerëve të vendosur paraprakisht. Para hedhjes(mbushjes) plasaritja(e çara) duhet të pastrohet nga pluhuri dhe uji i mbetur.

Materiali i përgatitur Adingpoks 1 mund të përdoret edhe për mbushjen e ankerëve të çeliktë.

## **PËRGATITJA E LLAÇIT EPOKSIDIK PËR SANACION**

Llaçi epoksidik përgatitet me përzierjen e ngadalshme të komponentëve A dhe B të Adinkpoksit 1 (deri në barazimin e plotë), e pastaj shtohet mbushje kuarc në përpjesëtim Adinkpoksit 1: Mbushjen S/H = 1:4 deri në 1:6. Për përzierje përdoret përzierësi(mixer-i) i ngadalshëm makinerik. Sipërfaqja ku është hedhur llaçi, përpunohet në mënyrë finale me mistri ("gletare")çeliku, me ç'rast materiali shtypet deri në mbylljen e tërësishme të strukturës sipërfaqësore. Sipas nevojës, si mbështjellës(lyerës) final mund të hidhet Adingpoks 1 ose ndonjë tjetër mbështjellës(lyerës) epoksidik për mbylljen përfundimtare të strukturës. Gjatë përdorimit të llaçit epoksidik për sanacion epoksidik rekomandohet të bëhen hulumtime paraprake.

Për ilustrim është dhënë tabela e mëposhtme, me rezultatet e analizës së llaçit epoksidik të përgatitur me Adingpok 1 dhe Mbushjen S/H (0,3-0,8 mm) dhe përpjestimi i përzierjes Adingpoks 1: Mbushja S/H = 1:4.

Faqja 2 nga 4

| CILËSIA                  | METODA   | VLERA E DEKLARUAR                        |
|--------------------------|----------|------------------------------------------|
|                          |          | A+B : Mbushje S/H (0,3-0,8 mm)<br>=1 : 4 |
| Përpjestimi i përzierjes | -        |                                          |
| Fortësia e lakimit       | EN 12190 | >15MPa                                   |
| Fortësia e shtypjes      | EN 12190 | >40MPa                                   |

## SHPENZIMI

Adingpoks 1 (si llyerës): 0,2-0,4 kg/m<sup>2</sup>

Për trashësinë e shtresës 1 cm (si llaç): 15,00 – 17,00 kg/m<sup>2</sup>

(Adingpoks 1 : Mbushje C/X (0,3-0,8 mm) = 1:4)

## PASTRIMI

Veglat dhe pajisjet pastrohen me Holluesin P menjëherë pas përdorimit.

## PAKETIMI

Në sete A+B: 3kg  
Komponenti A: 2kg  
Komponenti B: 1kg

Në sete A+B: 9kg  
Komponenti A: 6kg  
Komponenti B: 3kg

Në sete A+B: 300kg  
Komponenti A: 200kg  
Komponenti B: 100kg

## RUAJTJA

Në ambalazh origjinal dhe të mbyllur, në hapësira pa lagështi, në temperaturë prej 10- 30°C, të mbrojtur nga rrezet e drejtpërdrejta të diellit dhe nga ngrirja.

Afati i përdorimit: 9 muaj.

## SHENJA E PRODHIMIT TË CERTIFIKUAR

|                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br>2032                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| ADING AD Skopje,<br>Novoselski pat (ul 1409) br.11<br>1060 Skopje, North Macedonia<br>17<br>GDFO001/6<br>EN 1504-2:2004<br><b>ADINGPOKS 1</b><br>Epoxy surface protection system for concrete, for moisture control and improved physical and chemical resistance |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Adhesion strength by pull-off test                                                                                                                                                                                                                                | <b><math>\geq 2,0 \text{ N/mm}^2</math></b>                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Capillary absorption and permeability to water                                                                                                                                                                                                                    | <b><math>w &lt; 0,1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0,5}</math></b>                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Permeability to water vapour                                                                                                                                                                                                                                      | <b>Class III, <math>S_D &gt; 50 \text{ m}</math></b>                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Abrasion resistance                                                                                                                                                                                                                                               | <b><math>&lt; 3000 \text{ mg}</math></b>                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Impact resistance                                                                                                                                                                                                                                                 | <b>Class II <math>\geq 10 \text{ Nm}</math></b><br><b>After loading, no cracks, no delamination</b>                                                                                                                                                                                                                         |
| Resistance to severe chemical attack                                                                                                                                                                                                                              | <b>Class II: 28 days without pressure</b><br><b><math>\leq 50\%</math> reduction in Shore hardness after treatment in test liquids: petrol; diesel and motor oil;</b><br><b>10% <math>\text{CH}_3\text{COOH}</math>; 20% <math>\text{H}_2\text{SO}_4</math>; 20% <math>\text{NaOH}</math>; 20% <math>\text{NaCl}</math></b> |
| Reaction to fire                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>Class F</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Dangerous substances                                                                                                                                                                                                                                              | <b>No performance determined</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                            |

Rreziku për shëndetin: Duhet të evitohet kontakti i prodhimit me lëkurën ose sytë, si dhe të thithjes me frymëmarrje gjatë përzierjes së komponentëve A dhe B. Në rast të kontaktit të papritur, prodhimi duhet të largohet menjëherë me leckë të thatë ose të lagur pakëz me Hollues P, e pastaj vendi duhet të pastrohet mirë me ujë të pastër dhe sapun. Nëse materiali jua spërkat sytë, menjëherë sytë duhet të shpërlahen me ujë të pastër dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Duhet poashtu të sigurohet ajrosje të hapësirave ku punohet me rrëshira dhe hollues.

Zjarri: Prodhimi nuk ndizet.

Pastrimi dhe ruajtja: Mbeturinat e shpërndara të Adingpoksit 1 pastrohen me Holluesin P. Ambalazha e vjetër që është përdorur duhet të ruhet sipas normativës dhe rregullativës lokale për këtë lloj të mbeturinave.

Rekomandojmë që mënyra e hedhjes dhe sasisë së nevojshme të adaptohen sipas kushteve të objektit, si dhe të përdoret pajisje përkatëse e detyrueshme.

Informacione plotësuese janë dhënë në Certifikatën e sigurisë së prodhimit.